

## KARAKTERISTIKAT BIO-MORFOLLOGJIKE DHE TEKNOLOGJIA E KULTIVIMIT TE FASULES

### Llojet autoktone të fasules në rajonin e Korçës

<u>Fasule e Eçmenikut</u>	<u>Fasule Trenare</u>
<p style="text-align: center;"><b>Karakteristikat bio-morfollogjike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Koha e mbjelljes: fundi i Prillit.</li> <li><input type="checkbox"/> Periudha e mbirjes: rreth tre javë.</li> <li><input type="checkbox"/> Tipi i bimës: kaçube e shkurtër.</li> <li><input type="checkbox"/> Forma e gjetthes: trekëndëshe.</li> <li><input type="checkbox"/> Numri i ditëve deri në lulëzim: 50</li> <li><input type="checkbox"/> Zgjatja e periudhës së lulëzimit: 25 ditë.</li> <li><input type="checkbox"/> Ngjyra e luleve: e bardhë.</li> <li><input type="checkbox"/> Forma e bishtajës: e përkulur lehtë.</li> <li><input type="checkbox"/> Gjatësia e bishtajës: 11 cm.</li> <li><input type="checkbox"/> Numri i bishtajave për bimë: 15.</li> <li><input type="checkbox"/> Numri i kokrrave në bishtajë: 4-6.</li> <li><input type="checkbox"/> Ngjyra e cipës së farës: e bardhë.</li> <li><input type="checkbox"/> Gjatësia e farës (mm): 15</li> <li><input type="checkbox"/> Gjërësia e farës (mm): 9</li> <li><input type="checkbox"/> Diametri i farës (mm): 4</li> <li><input type="checkbox"/> Pesha e 1000 farave (gr): 440</li> <li><input type="checkbox"/> Periudha vegetative mbirje - pjekje: 95 ditë.</li> <li><input type="checkbox"/> Qëndrueshmëria (sëmundje-dëmtues): e lartë.</li> <li><input type="checkbox"/> Qëndrueshmëria ndaj thatësirës: mesatare.</li> <li><input type="checkbox"/> Prodhimi për 1 dy (kg): 60</li> </ul>	<p style="text-align: center;"><b>Karakteristikat bio-morfollogjike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Koha e mbjelljes: fundi i Prillit.</li> <li><input type="checkbox"/> Periudha e mbirjes: rreth tre javë.</li> <li><input type="checkbox"/> Tipi i bimës: kaçube e shkurtër.</li> <li><input type="checkbox"/> Forma e gjetthes: trekëndëshe.</li> <li><input type="checkbox"/> Numri i ditëve deri në lulëzim: 52</li> <li><input type="checkbox"/> Zgjatja e periudhës së lulëzimit: 25 ditë.</li> <li><input type="checkbox"/> Ngjyra e luleve: e bardhë.</li> <li><input type="checkbox"/> Forma e bishtajës: e përkulur lehtë.</li> <li><input type="checkbox"/> Gjatësia e bishtajës: 12 cm.</li> <li><input type="checkbox"/> Numri i bishtajave për bimë: 14.</li> <li><input type="checkbox"/> Numri i kokrrave në bishtajë: 4-5.</li> <li><input type="checkbox"/> Forma e farës: formë veshke.</li> <li><input type="checkbox"/> Gjatësia x gjërësia e farës (mm): 16 x 9.</li> <li><input type="checkbox"/> Diametri i farës (mm): 4</li> <li><input type="checkbox"/> Pesha e 1000 farave (gr): 460</li> <li><input type="checkbox"/> Periudha vegetative mbirje - pjekje: 100 ditë.</li> <li><input type="checkbox"/> Qëndrueshmëria (sëmundje/dëmtues): mesatare</li> <li><input type="checkbox"/> Qëndrueshmëria ndaj thatësirës: mesatare.</li> <li><input type="checkbox"/> Prodhimi për 1 dy (kg): 110.</li> </ul> <p style="text-align: center;">Etj.</p>



## **TEKNOLOGJIA E KULTIVIMIT TE FASULES**

### **Afati i mbjelljes**

Një nga elementet kryesor të teknologjisë që ndikon në zbutjen e stresit dhe rritjen e stabilitetit të prodhimit është afati i mbjelljes. Ky afat realizon përputhjen e kerkesave biologjike të fasules me kushtet klimatike të zonës. Afati i mbjelljes lidhet kryesisht me temperaturat në fazën e mbirjes dhe ato të fazës riprodhuese.

Zgjedhja e tokave të përshtatshme lejon harmonizimin e këtij elementi me numrin e bimëve, i cili sintetizohet në thenien “Mbill në afatin optimal për të siguruar numrin optimal të bimëve”.

Koha më e përshtatshme për mbjellje është kur temperaturat janë mbi 10—12 gradë celsius. Për kushtet e zonës së ulët bregdetare këto temperatura arrihen nga fundi i Marsit deri në mesin e Prillit. Për zonat veriore, verilindore dhe juglindore afati optimal fillon nga mesi i Prillit deri në fund të tij.

Si rregull mbjellja duhet të fillojë më herët në tokat e ngrohta,

nëndeltinore të mesme, kodrinore dhe të ekspozuara nga jugu. Ndërsa duhet të fillojë më vonë në tokat e ftohta, të bardha dhe me ekspozim nga veriu.

## **Kërkesat e fasules për temperaturë**

**Biologjia e lulëzimit** dhe e prodhimit të fasules ka kërkesa specifike ndaj temperaturave e si më poshtë:

- Gjatë mbirjes: minimale 10-12 ° C; maksimale 20-22 ° C
- Gjatë periudhës vegetative min. 18-24 ° C; maks. 27-29 ° C
- Gjatë periudhës riprodhuese min. 20-25 ° C; maks. 29-34 ° C

**Ndryshimet e klimës** po rrisin temperaturat mesatare të këtyre tre fazave mbi optimalet e kërkuara. Rritja e temperaturave mbi optimalen gjatë vegetacionit dhe sidomos gjatë fazës riprodhuese përbënë stres për prodhimin e kësaj bime.

## **Biologjia e lulëzimit**

Formimi i shumë luleve në bimën e fasules është një mekanizëm i bimës për të siguruar një prodhim normal

Zgjatja e periudhës së lulëzimit varet prej shumë faktoreve, ku më të rëndësushëm janë:

- 20 ditët e para të kësaj periudhe kanë mundësi për të realizuar prodhim të lartë.
- brenda kësaj periudhe rreth 80 % e prodhimit realizohet gjatë 11-12 ditëve të para të lulëzimit, pasi rënia e luleve pas këtyre ditëve është një fenomen i zakonshëm.
- vendimtare në realizimin e prodhimit janë 4-5 ditët e para pas çeljes së lules së parë, sepse lulet që çelin gjatë këtyre ditëve lidhin më tepër bishtaja në pjesën e poshteme të bimës.

## **Elementet e teknologjise që mund të përmirsohen.**

Bima e fasules karakterizohet nga cikël bimor i shkurtër që është karakteristikë: Gjenotipit + kushtet klimatike të zonës së kultivimit.

Kultivarët me cikël bimor të gjatë kanë aftësi prodhuese më të lartë në krahasim me ato me cikël të shkurtër. Por në kushtet klimatike me temperatura jashtë optimaleve (stresuese) gjatë gjithë periudhës riprodhuese këta kultivarë nuk mund të kompesojnë ndikimet negative, për pasojë ata karakterizohen nga një prodhim dhe stabilitet i ulët.

Për të minimizuar ndikimin negativ të kushteve klimatike është e nevojshme zëvendësimi i kultivarëve me cikël bimor të gjatë me ato me cikël bimor të shkurtër ose të hershëm.

Kultivarët e hershëm karakterizohen nga:

- Ndërtim arkitekturor të ndryshëm të bimeve.
- Vendosje vertikale të getheve.
- Lulëzim më të hershem dhe më intensiv.
- Prodhim më uniform sepse sepse këta kultivarë pjesën më të madhe të organeve frutore e lidhin 10-12 ditët e para pas çeljes së lules së parë.
- Kanë stabilitet më të lartë prodhimi.

**Kontribut i Projektit:** LoA/TFIW2APR-01/ALBANIA 12015/AGDT): “Forcimi i ruajtjes dhe i përdorimit në fermë të Resurseve Gjenetike të Bimëve për Bujqësinë dhe Ushqimin, për mbështetjen e fermerëve në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe përmirësimin e jetesës në Shqipëri”. 2015—2018.

%